



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2368/4 prot.

Tiranë, më 13.10.2025

**VENDIM**

**Nr. 34, datë 13.10.2025**

**PËR**

**RRËZIMIN E ANKESËS**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) formularin e ankesës nr. 2368 Prot., datë 19.09.2025, saktësuar me nr.2368/1 Prot., datë 24.09.2025, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e gazetarit pranë Qendrës Citizens Channel, me anë të shkresës datë 30.07.2025 ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni, si vijon:

1. *Cili institucion ose autoritet publik ka marrë vendimin për rindërtimin e kësaj rezidence?*
2. *Kur është dhënë leja e ndërtimit për ndërhyrjen në këtë objekt dhe nga cili institucion?*
3. *Cili është subjekti projektues (studio arkitekturore ose grup pune) që ka hartuar projektin?*
4. *Cila kompani ka realizuar punimet dhe në çfarë forme është kontraktuar (procedurë prokurimi ose kontratë tjetër)?*
5. *Cila është vlera totale e projektit dhe burimi i financimit?*

6. *Kur kanë filluar dhe kur kanë përfunduar zyrtarisht punimet?*
7. *A është përfshirë ndonjë konsultim publik apo dokumentim për trashëgimi kulturore, duke qenë se objekti ndodhet në një zonë rezidenciale shtetërore?*

Ndërkohë, nëpërmjet shkresës datë 14.08.2025, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni si vijon:

1. *Pse u përdor procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës? Kopje elektronike të dokumentacionit që e justifikoi përdorimin e kësaj procedure.*

*Ndërkohë, sipas procedurave të ndjekura:*

- *Projektimi i Projektit Rivitalizues të Rezidencës Qeveritare Vila Nr. 5 u tenderua me procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës sipas urdhrimit të prokurimit Nr. 1208, datë 12.09.2022 ku fitues u shpall studioja “Atelier 4” me të cilën u lidh kontrata me Nr. Prot. 6/15, datë 17.11.2022. Për këtë ka kërkuar:*
2. *Kopje të dokumentit zyrtar të arsyetimit për zgjedhjen e procedurës “me negociim pa shpallje paraprake” apo çdo dokument që justifikoi urgjencën, mungesën e konkurrencës ose dështimin e një procedure të hapur paraprake rreth këtij tenderi.*
  3. *Kopje të dosjes së tenderit: ftesat për operatorët, dokumentet e ofertës, procesverbalet e negociatave, vlerësimet teknike dhe financiare.*
  4. *Kopje të kontratës Nr. Prot. 6/15, datë 17.11.2022 me të gjitha anekset dhe shtesat.*
    - *Zbatimi i projektit të rivitalizimit të Rezidencës Qeveritare Vila Nr. 5 u tenderua me procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës sipas urdhrimit të prokurimit Nr. 339, datë 15/03/2023 ku fitues u shpall “AD-STAR” sh.p.k. me të cilën u lidh kontrata Nr. Prot. 3/22, datë 18.04.2023. Për këtë ka kërkuar:*
  5. *Kopje të dokumentit zyrtar të arsyetimit për zgjedhjen e procedurës “me negociim pa shpallje paraprake” apo çdo dokument që justifikoi urgjencën, mungesën e konkurrencës ose dështimin e një procedure të hapur paraprake rreth këtij tenderi.*
  6. *Kopje të dosjes së tenderit: ftesat për operatorët, dokumentet e ofertës, procesverbalet e negociatave, vlerësimet teknike dhe financiare.*
  7. *Kopje të kontratës Nr. Prot. 3/22, datë 18.04.2022 me të gjitha anekset dhe shtesat.*
    - *Mbikëqyrja e punimeve të projektit të rivitalizimit të Rezidencës Qeveritare Vila Nr. 5 u tenderua me procedurë me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës sipas urdhrimit të prokurimit Nr. 340, datë 15.03.2023 ku fitues u shpall “Dricons” shpk me të cilën u lidh kontrata Nr. Prot. 4/25, datë 18.04.2023. Për këtë ka kërkuar:*
  8. *Kopje të dokumentit zyrtar të arsyetimit për zgjedhjen e procedurës “me negociim pa shpallje paraprake” apo çdo dokument që justifikoi urgjencën, mungesën e*

- konkurrencës ose dështimin e një procedure të hapur paraprake rreth këtij tenderi.*
9. *Kopje të dosjes së tenderit: ftesat për operatorët, dokumentet e ofertës, procesverbalet e negociatave, vlerësimet teknike dhe financiare.*
  10. *Kopje të kontratës Nr. Prot. 4/25, datë 18.04.2022 me të gjitha anekset dhe shtesat.*
  11. *Raportet e mbikëqyrjes dhe procesverbalet e dorëzimit të punimeve.*

Gjithashtu, referuar përgjigjes së Autoritetit Publik me Nr. Prot. 3592/1, datë 28.08.2025, ankuesi me anë të kërkesës datë 02.09.2025, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion dokumentacioni si vijon:

1. *Çdo dokumenti zyrtar që përjashtoi përdorimin e procedurave të hapura, përfshirë dokumentacionin që provon apo justifikon faktin se ky objekt i përmbush kriteret ligjore për trajtim nën ligjin nr. 36/2020.*  
*Klasifikimi i informacionit të kërkuar si “Konfidencial”, sipas ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar” që ju citoni, bëhet mbi bazën e një vendimi të arsyetuar dhe të dokumentuar të një autoriteti përgjegjës, i cili duhet të jetë në përputhje me:*
  - *Nenin 6 të këtij ligji, që përcakton kategoritë dhe kriteret për klasifikim;*
  - *dhe parimit, që kërkon mbajtjen e një regjistri zyrtar të vendimeve për klasifikim dhe përcaktimin e afateve të rishikimit të tyre.**Për sa më sipër, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje të:*
2. *Vendimit ose akteve zyrtare që klasifikoi si “Konfidencial” dokumentacionin që lidhet me procedurat e tenderimit të rikonstruksionit të Rezidencës Qeveritare Vila Nr. 5, përfshirë kontratat apo projektin teknik.*

Autoriteti Publik, lidhur me kërkesën e parë, nëpërmjet shkresës nr. 3452 Prot., datë 12.08.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *“...procedurat e mirëmbajtjes së Rezidencës Qeveritare Vila nr. 5, Sauk Tiranë, janë ndërmarrë për të garantuar ruajtjen funksionale dhe fizike të objektit, i cili ka status të veçantë si pasuri shtetërore në përdorim të institucioneve të larta shtetërore ose për qëllime protokollare...*

*Në rastin konkret, objekti Rezidenca Qeveritare Vila nr. 5, Sauk Tiranë, nuk rezulton të jetë shpallur monument kulture, nuk ndodhet brenda një zone të mbrojtur historike dhe nuk është evidentuar si pasuri me status të propozuar për mbrojtje, për këtë arsye për të nuk aplikohen parashikimet e Ligjit nr. 27/2018 dhe, si rrjedhojë nuk kërkohet zhvillimi i konsultimeve publike apo miratimi nga autoritetet e trashëgimisë kulturore për ndërhyrjet e kryera.*

*Nga sa më sipër, referuar informacionit mbi procedurat e ndjekura, shpenzimet dhe subjektet në këtë procedurë, të dhënat e kërkuara janë të aksesueshme nëpërmjet sistemit të prokurimit publik elektronik në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP): <https://www.app.gov.al>”.*

Lidhur me kërkesën e dytë, Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës me nr. 3592/1 Prot., datë 28.08.2025, ka sqaruar se: *“...Procedurat e prokurimit janë realizuar në bazë të*

Ligjit 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, i cili parashikon aplikimin e procedurës së negociimit pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës në rastet e parashikuara nga ligji. Në këtë kuadër, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, ka ndjekur këtë procedurë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Referuar dokumentacionit të kërkuar që lidhet me projektin e rikonstruksionit të objektit, përfshirë subjektin projektues, procedurat e kontraktimit dhe afatet e zbatimit, ky material përbën informacion të klasifikuar në nivel “Konfidencial”, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Ky ligj parashikon se informacionet që lidhen me sigurinë kombëtare, mbrojtjen e rendit dhe funksionimin e strukturave shtetërore me funksione të posaçme, mund të kufizohen nga e drejta e informimit dhe nuk bëhen publike.

Duke qenë se dokumentacioni i kërkuar nga ana Juaj pranë DSHQ-së është i klasifikuar në nivel “Konfidencial”, për qëllime sigurie dhe në përputhje me kuadrin ligjor, nuk mund t’ju vendosen në dispozicion”.

Ndërkohë, për kërkesën e tretë, nëpërmjet shkresës me nr. 3854/1 Prot., datë 17.09.2025, ka sqaruar se: “...Sa i përket dokumentacionit shoqëruar mbi përjashtimin nga procedurat e hapura dhe vendimmarrjes për klasifikim, bëjmë me dije se ky material është administruar dhe vlerësuar nga autoritetet kompetente sipas ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Në përputhje me nenin 6, nenin 12 dhe nenin 28 të këtij ligji, e drejta për njohjen me informacion të klasifikuar i takon vetëm:

- personave që e kanë këtë të drejtë për shkak të detyrës dhe që janë të informuar për procedurat e sigurisë, si dhe të pajisur me certifikatë sigurie personale (CSP);
- Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe Kryetarit të Kuvendit, të cilët e kanë këtë akses të garantuar pa iu nënshtruar procedurave të verifikimit të sigurisë.

Çdo subjekt tjetër, përfshirë organizata të medias, nuk mund të njihet me dokumentacionin e klasifikuar, pasi bërja e tij publike do të cënonte interesat eprore të Shtetit në kuptim të ligjit të sipërcituar.

Për sa i përket argumentit të parashtruar në shkresën tuaj sipas të cilit Vila 5 nuk përbën një strukturë të klasifikueshme automatikisht si e ndjeshme për sigurinë kombëtare për arsye se “është përdorur për qëllime protokollare dhe është prezantuar publikisht një festival ndërkombëtar”, sjellim në vëmendje se funksionet e personaliteteve të larta shtetërore ushtrohen në mënyrë zyrtare në format protokollar dhe identifikohen e klasifikohen pikërisht nga synime, objekt dhe qëllime protokollare. Në rastin konkret, përveç faktit që event i zhvilluar në rezidencën qeveritare Vila 5 kryesohej nga Kryeministri në kuadër të ushtrimit të veprimtarive të tij protokollare, kemi të bëjmë me një pritje personalitetesh të rëndësishme pa rang zyrtar të parashikuar në mënyrë eksplicite nga pika 8.1, Kap. V, i VKM nr. 420, datë 8 qershor 2016 “Për miratimin e Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë”:

“Nëse në Shqipëri vijnë për vizitë të ftuar nga autoritetet e larta të vendit, personalitete të veçanta pa rang zyrtar (...) drejtues fondacionesh të rëndësishme, përfaqësues të mëdhenj të artit, kulturës (...), ndaj tyre zbatohet një protokoll i veçantë”.

Për rrjedhojë, duke pasur parasysh cilësinë e të ftuarve në eventin e përmendur nga ju, mirëpritja e tyre në një rezidencë qeveritare, strukturë e klasifikuar si e ndjeshme për sigurinë kombëtare, përkon saktësisht me veprimtari protokollare të parashikuara nga

*legislacioni në fuqi që zhvillohen në struktura të dedikuara për ushtrimin e detyrës nga personalitetet e larta shtetërore ftuese. Kuptohet nga sa më sipër se kjo veprimtari nuk bie ndesh, por veç e konfirmon natyrën e veçantë të rezidencës qeveritare në fjalë. Së fundmi, ekspozimi mediatik i një pjese të mjediseve të kësaj rezidence, e cila nuk është një objekt sekret, nuk çënon në vetvete statusin e një strukture të ndjeshme për sigurinë kombëtare për sa kohë ky ekspozim nuk detajon aspektet teknike të ndërtimit dhe të strukturës që janë mirëfilli objekt i klasifikimit.*

*Nga sa më sipër rezulton se dokumentacioni i kërkuar nga ana juaj përfshihet në kategorinë e informacionit të klasifikuar dhe i nënshtrohet kufizimeve ligjore të aksesit. DSHQ, në zbatim të detyrimeve ligjore, nuk është e autorizuar t'ju vërë në dispozicion materialet e kërkuara për shkak të mosplotësimit të kushteve.”*

Ndodhur në këto kushte, ankuesi ka paraqitur ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së dokumentacionit nga Autoriteti Publik, konkretisht, për kërkesën e parë pikat: 1, 2, 5, 6, për kërkesën e dytë pikat: 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, si dhe për kërkesën e tretë pikat: 1, 2.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 2368/2 prot., datë 25.09.2025, qëndrimin e Autoritetit Publik në lidhje me pretendimin e ngritur në ankesën objekt shqyrtimi, duke rivlerësuar kërkesën për informacion në raport me pikën 5, të nenit 17 të LDI.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 4231/4 Prot., datë 03.10.2025, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 2368/3 Prot., datë 07.10.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*...Në zbatim të nenit 17, pika 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mblodhi Komisionin për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin e Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, me objekt shqyrtimin e statusit të dokumentacionit të kërkuar. Pas një analize të plotë të dokumenteve dhe duke respektuar dispozitat e Ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, komisioni vendosi se:*

- 1. Përgjigjet e dhëna më parë ndaj subjektit Citizians Channel për kërkesat për informacion (shkresat nr. 1, 2, 3 dhe 4) janë trajtuar dhe kthyer në përputhje me ligjin, duke ofruar çdo informacion të aksesueshëm publikisht. Përmbajtja e përgjigjeve është e plotë dhe shteruese në raport me pyetjet e ngritura.*
- 2. Dokumentacioni i kërkuar, i klasifikuar si “Sekret Shtetëror”, nuk përmbush kushtet ligjore për deklasifikim, pasi dhënia e tij do të konsiderohej si shkelje e ligjit*

*nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Për këtë arsye, ai nuk mund të vihet në dispozicion të palëve të treta, përveç rasteve të parashikuara nga ligji.”*

Nga shqyrtimi i çështjes, Komisioneri konstaton se, objekti i kërkesës, ka të bëjë me informacion i cili është rregulluar nga dispozitat e ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Autoriteti Publik nëpërmjet akteve të trajtuara si më sipër cituar, ka sqaruar se dokumentacioni objekt shqyrtimi *përbën informacion të klasifikuar*. Ndërkohë, pas caktimit të detyrimit nga Komisioneri për të rivlerësuar kërkesën për informacion në raport me pikën 5, të nenit 17 të LDI, Autoriteti Publik, ka trajtuar kërkesën sipas dispozitës ku parashikohet se: “...5. E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr.10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkuuesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kriterëve të këtij neni.”

Në vijim, bazuar në parashikimet e sipër cituara, Autoriteti Publik ka sqaruar ndër të tjera se: “...Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare mblodhi Komisionin për Deklasifikimin dhe Zhvlerësimin e Informacionit të Klasifikuar “Sekret Shtetëror”, me objekt shqyrtimin e statusit të dokumentacionit të kërkuar.

*Pas një analize të plotë të dokumenteve dhe duke respektuar dispozitat e Ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, komisioni vendosi se: Dokumentacioni i kërkuar, i klasifikuar si “Sekret Shtetëror”, nuk përmbush kushtet ligjore për deklasifikim, pasi dhënia e tij do të konsiderohej si shkelje e ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”.*

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se në parim dokumentacioni objekt shqyrtimi përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të LDI, në rastin konkret e drejta për informim kufizohet në përputhje me shkronjën a) të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Rrëzimin e ankesës me nr. 2368 Prot., datë 19.09.2025, saktësuar me nr. 2368/1 Prot., datë 24.09.2025, të z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 13.10.2025.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**